

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 8013  
E shtunë, 15 mars 2025  
Çmimi 0.50

Prokuroria autorizon  
policinë t'i nisë hetimet  
ndaj Sami Kurteshit

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



**ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## SA KA URGJENCË PËR FORMIMIN E QEVERISË SË RE TË KOSOVËS?

FAQE 3



Gëzimi për numërimin e të gjitha votave të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë nuk zgjati shumë. Shumë shpejt nisi rinumërimi i

disa votave, ndërsa ankesat e partive politike u bartën prej një gjykate në tjetrën. Në gjithë këtë situatë, pashmangshëm lindin dilemat nëse ka tendencë për

zvarritje të procesit që duhet të rezultojë me formim të institucioneve të reja, apo gjithçka është brenda afateve ligjore

### RRUGAÇI I SPECIALES DHE KOLOSI THAÇI

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



### SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I RCC-së NË PRISHTINË, TAKON LIDERËT E VENDIT PËR TA FORCUAR BASHKËPUNIMIN RAJONAL

F. 3



### RRITET NUMRI I FLUTURIMEVE DHE I UDHËTARËVE ME AVION

F. 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



### ÇDO PËRBALLJE INTERESANTE NË SUPERLIGËN E BASKETBOLLIT

F. 6

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Armët amerikane vazhdojnë të shkrepn në fushëbetejë në Ukrainë

KIEV, 14 MARS - Armët e prodhimit amerikan janë duke u përdorur vazhdimisht në fushëbetejat e Ukrainës pavarësisht se Shtetet e Bashkuara e kishin pezulluar përkohësisht furnizimin e Kievit me armë. Furnizimi me municione dhe armë rifilloi më 12 mars, pasi ishte pezulluar për rreth një javë. Pezullimi ndodhi si rrjedhojë e një përplasjeje në Zyrën Ovale mes presidentit amerikan Donald Trump dhe atij ukrainas Volodymyr Zelensky më 28 shkurt. Gazetari i Radios Evropa e Lirë, Maryan Kushnir, u takua me trupa në vijën e frontit në rajonin lindor, Donjeck, në fillim të marsit. Ai i gjeti ata duke e përdorur obusin amerikan,

Paladin, dhe automjetet luftarake Bradley, si dhe obusin M777, i cili prodhohet në Shtetet e Bashkuara dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Këto armë përdorëshin vazhdimisht dhe plotësisht. “Trupat ukrainase kanë hapur zjarr intensiv pranë [qytetit të] Kurahovit”, tha Kushnir, duke qëndruar pranë një M777-shi. “Sapo kanë qëlluar më shumë se 20 predha dhe zjarri nuk është ndalur. Kjo lloj artilerie mbërrii në vitin 2022 nga Shtetet e Bashkuara. Ka shumë armë të tilla në vijën e frontit dhe ato përdoren gjerësisht, ashtu si edhe predhat me kalibër të NATO-s. Zjarri nuk ndalet kurrë, siç mund ta shihni”, tha ai. Ushtarët që i intervistoi Kushnir



thanë se besojnë që pezullimi i ndihmës ushtarake ka pasur pak ndikim deri tani. “Për sa di unë, ne po prodhojmë predha tani, kështu që nuk mendoj se do të kemi probleme me furnizimin”, i tha Kushnirit një ushtar i

paidentifikuar. “Dhe do t’i kemi ende këto armë. Nëse ndodh diçka në të ardhmen, mund t’i riparojmë. Ato po riparohen dhe po rikthehen në gjendje pune që t’i përdorim sërish”. “Nuk është vetëm Amerika që

po na ndihmon”, tha një ushtar tjetër i paidentifikuar. “Ne do të rezistojmë dhe kjo situatë do të përfundojë”. Sipas Institutit Kiel për Ekonominë Botërore, me bazë në Gjermani, Shtetet e Bashkuara ofruan 67 miliardë dollarë ndihmë ushtarake nga fillimi i pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia në shkurt 2022 deri në dhjetor 2024. Evropa ofroi 65 miliardë dollarë në të njëjtën periudhë. Fedir Venislavsky, i cili është anëtar i komitetit të mbrojtjes në parlamentin ukrainas, vlerësoi në fillim të marsit se furnizimi i Ukrainës me armë do të mjaftojë vetëm për gjashtë muaj pa ndihmën ushtarake të ShBA-së.

## “Studentët 2.0” thonë se do ta vazhdojnë protestën në Beograd

BEograd, 14 MARS- Grupi i studentëve që protestojnë në Parkun e Pionierit në Beograd dhe kërkojnë ndalimin e bllokadave të fakulteteve do të qëndrojnë aty edhe më 15 mars, kur është planifikuar protesta e studentëve dhe qytetarëve, tha të premten Millosh Pavloviq, përfaqësues i grupit “Studentët 2.0”. Ai tha se të mbledhurit në Parkun e Pionierit, pas takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, më 13 mars, morën këtë vendim pasi analizuan “çdo aspekt”. “Ne, studentët që duam të mësojmë,



do të qëndrojmë në Parkun e Pionierit deri në një njoftim të dytë. I kuptojmë të gjithë ata që mendojnë se duhet të largohemi nga ky park të shtunën, e kuptojmë edhe presidentin e Republikës, por edhe ju duhet të na kuptoni neve. Ne jemi këtu në mënyrë legjitime”, tha Pavloviq. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, u takua të enjten me përfaqësuesit e grupit “Studentët 2.0” dhe u kërkoi atyre që të largohen nga Parku i Pionierit për një ditë, më 15 mars, kur është planifikuar protesta e studentëve dhe

qytetarëve. Ata i premtuan atij se do ta njoftonin vendimin e tyre brenda 24 orëve. Në një konferencë për medie në këtë park, Millosh Pavloviq u bëri thirrje bujqve që të vijnë dhe të mbështesin “studentët që duan të mësojnë”. Të premten mediet raportuan se një numër i madh traktorësh ishin parkuar rreth Parkut të Pionierit në qendër të kryeqytetit serb, Beograd. Gjatë deklaratës së tij për mediet, përfaqësuesi i “Studentëve 2.0” nuk përmendi makineritë bujqësore të parkuara pranë kampit të tyre.

## Putini e sheh me “optimizëm të kujdesshëm” planin e Trumpit, por Zelensky është skeptik ndaj motiveve të tij

UASHINGTON, 14 MARS - Kremli tha se ka arsye për “optimizëm të kujdesshëm” për propozimin e presidentit amerikan Donald Trump për një armëpushim 30-ditor, ndërkaj Ukraina ka vënë në pikëpyetje sinqeritetin e Moskës lidhur me përfundimin e luftës, që tashmë ka hyrë në vitin e katërt. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, u tha gazetarëve në Moskë më 14 mars se presidenti rus, Vladimir Putin, i ka dërguar Trumpit një mesazh për propozimin e tij për armëpushim në Ukrainë, pasi ka zhvilluar bisedime gjatë natës në Moskë me të dërguarin e posaçëm amerikan, Steve Witkoff. “Kur z. Witkoff t’ia dërgojë të gjitha informacionet presidentit Trump, ne do të përcaktojmë kohën e bisedës [mes Trumpit dhe Putinit]. Ka arsye për të qenë optimistë të kujdesshëm”, tha Peskov.

Putini tha një ditë më herët se ai pajtohet në parim me propozimin e SHBA-së për një armëpushim të përkohshëm me Ukrainën, por shtoi se “ka disa nuanca” sikurse dërgesat e armëve perëndimore në Kiev, që ai dëshiron që t’i adresojë fillimisht. Udhëheqësi rus po ashtu tha se çdo marrëveshje duhet të çojë në një paqe afatgjatë që do të adresonte arsyet “thelbsore” për luftën – me gjasë referencë për zgjerimin e NATO-s. Në një video të publikuar në orët e vona të 13 marsit, presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, vuri në pikëpyetje motivet e Putinit, duke thënë se udhëheqësi rus ishte i gatshëm të refuzonte propozimin, por kishte frikë që këtë t’ia thoshte Trumpit. “Prandaj, në Moskë idesë së armëpushimit po i imponohen këto kushte, që të mos ndodhë asgjë ose të mos ndodhë asgjë

për një kohë sa më të gjatë”, tha Zelensky. Putini po përballë me një dilemë pasi delegacionet nga Kiev dhe Uashingtoni janë pajtuar më herët gjatë javës në një takim në Arabinë Saudite për një armëpushim 30-ditor të propozuar nga Trumpi, duke e vendosur topin në fushën e Moskës. Trumpi e cilësoi si “premtues”, por të pamjaftueshëm reagimin fillestar të Putinit lidhur me bisedimet e paqes, megjithëse udhëheqësi amerikan tha se shpreson që Rusia “do të bëjë gjënë e duhur” dhe të pajtohet për marrëveshje. “Mendoj se rusët janë të interesuar që të mos shihen si pala e paepur, pasi kjo mund të çojë në pasoja nga Trumpi, sikurse janë sanksionet”, tha për Radion Evropa e Lirë, John Hardie, zëvendësdyrëtor i Programit për Rusinë në Fondacionin për Mbrojtjen e



Demokracive, institut me seli në Uashington. Trumpi e ka bërë prioritet kryesor përfundimin e luftës së Rusisë kundër Ukrainës që kur nisi mandatin e dytë presidencial në janar, po e përdor ndikimin e ShBA-së për të çuar drejt tavolinës së negociatave Kievin dhe Moskën. Më 13 mars administrata amerikane rriti presionin ndaj Rusisë duke shtuar kufizimet ndaj sektorëve të naftës, gazit dhe sektorit bankar. Putin tha po ashtu se disa pyetje

janë të paadresuar në propozim, siç është çështja se çfarë të bëhet me ofensivën e Ukrainës në rajonin rus të Kurskut. “Nëse kemi një armëpushim, a do të thotë kjo se të gjithë ata do të largohen”, tha Putin. “A duhet t’i lirojmë ata [trupat ukrainase] pasi kryen krime kundër popullatës? Apo ata do të dorëzohen?”. Ukraina mori zona të mëdha në Kursk pas një ofensive befasuese në gushtin e kaluar, ofensivë që u pa si përpjekje për të larguar forcat ruse nga lindja e Ukrainës dhe për ta përdorur territorin e kapur rus si kartë në ndonjë negociatë të paqes. Kjo strategji tashmë po dështon pasi forcat ruse, të mbështetura nga trupat e Koresë së Veriut, po dëbojnë ukrainasit nga Kursku. Rusia ka rimarrë mbi gjysmën e territorit në Kursk që Ukraina kishte marrë fillimisht nën kontroll.



# RRUGAÇI I SPECIALES DHE KOLOSI THAÇI



**Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA**

**Mizëria dhe poshtërsia:** Presidenti i rrëmbyer nga burokratët banditë ndërkombëtarë, Hashim Thaçi, thuaja pesë vjet po mbahet peng bashkë me bashkëluftëtarë dhe themelues të shtetit në Hagë, si çmim për poshtërsitë në kurriz të Kosovës nga ata që e arrestuan, kryesisht ndërkombëtarë dhe nga ata që u gëzuan dhe i ndihmuan, thuaja i tërë kabineti Kurthi 2. Presidentit Thaçi katër herë iu refuzua kërkesa e mbrojtësve të Hagës që t’i lejohet vizita babait të sëmurë rëndë, thuaja 87-vjeçar e që po trajtohet, jo në klinikat elitare ndërkombëtare, por në QKUK, ku trajtohen dhe vdesin vdekatarët e rëndomtë. Dhunuesit e


Hagës, me refuzimin e lejimit të një vizite humanitare, katër herë dhunuan të drejtat e njeriut dhe katër herë dhunuan “Rregullat e Nelson Mendelës”, si standarde më të larta të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria sipas Kombeve të Bashkuara. Përkundër një urrejtje të shfrenuar të pushtetarëve aktualë kundër presidentit Thaçi, luftës Çlirimtare dhe UÇK-së si dhe pengjeve të Hagës, një numër i qytetarëve shkoi në QKUK për të përkrahur çlirimtarët dhe UÇK-në ndonëse nuk kishte fare informata për këtë vizitë. Pushteti fare nuk reagoi për këtë vizitë pasi nuk kishte mundësi ta ndalonte. Pushteti nuk reagoi fare për këtë vizitë ani pse shteti i Kosovës po nënçmohet dhe bullizohet brutalisht nga dhunuesit e Hagës duke mos përfillur asnjë ligj apo kod moral të Kosovës. Këto vizita jo se nuk janë aspak humanitare por janë skajshmërisht poshtëruese që cenojnë rëndë shtetin dhe Kushtetutën e Kosovës, shpërfillin sovranitetin, e dhunojnë integritetin territorial dhe moral. Një

polic i thjeshtë i kësaj gjykate ka më shumë autoritet dhe fuqi se KM Kurthi, presidentja Vojsa Osmani dhe kryetari i Kuvendit, Glauk bin Konjufca. Bllokimi i rrugëve nga aeroporti e deri te QKUK-ja, vendosja e shtetrrëthimit policor në QKUK dhe masat rigoroze ndaj familjarëve, nuk kanë të bëjnë asgjë me ligjet e Kosovës apo me një vizitë humanitare. Edhe më Kosovë por edhe në vendet me një demokraci të zhvilluar me një standard të respektimit të drejtave të njeriut mundësohen këto vizita por se nuk janë aq poshtëruese apo degraduese siç po e bëjnë cubat juridikë të Hagës. Edhe Tribunali për Krime Luftë për ish-Jugosllavinë në Hagë lejonte këso vizita por kushtet ishin në përputhje të plotë me dinjitetin e njeriut. Gjithmonë e pyes veten pse duhet të pranohen këto vizita nga pengjet e Hagës që janë aq poshtëruese?! Edhe në kohën kur isha në burgjet e ish-Jugosllavisë, unë dhe shumë shokë kemi pasur raste të vdekjeve të prindërve dhe anëtarëve të familjes së ngushtë por

asnjëherë nuk kemi bërë kërkesë të na lejohet të marrim pjesë në varrim apo kryeshëndosh. Ishte qëndrim i të burgosurve politikë shqiptarë të mos bëjmë kërkesa të tilla. Sigurisht edhe nuk do të na lejonin përveç se këto kërkesa do t’i bënin pjesë të dosjes. Kur më ka vdekur babai isha në izolim një vit bashkë me disa shokë në Burgun e Gospiqit në Kroaci. Të pamën për vdekjen e babait ma organizuan Hysen Shurdhani dhe Hilmi Muzaqi në njërën nga dhomat e Burgut. Sjellja e një polici të Gjykatës Raciste Speciale ndaj një mjeku që e përqafoi presidentin Thaçi ishte sjellje e një rrugaçi, një huligani, një banditi kriminel që shkelë brutalisht shtetin që nuk është i tij e që nuk ka të bëjë asgjë me të përveç se e shpërfaq një rrugaçëri prej mujshari në kohën kur shteti i Kosovës as nuk ka vullnet e as nuk guxon të reagojë. Mjekët as gjatë veprimeve luftarake nuk guxojnë të pengohen e as të kërcënohen për punën e tyre. Ky faqezi i maskuar që mundohet të mbulojë diçka që nuk e ka fytyrën, vetëm në Kosovë mund të sillt

kështu, në vendet tjera nuk do ta duronin. Kjo më së miri tregon se sa jemi të pavarur dhe sovran. E tmerrshme është kjo! Është e pabesueshme se n’çmasë manifestohet urrejtja ndaj luftës dhe UÇK-së. Personi fizik mund të burgoset, historia jo. Hashim Thaçi është vet historia, e Kosovës, shqiptarëve dhe e të gjithë atyre që luftojnë për liri, pavarësisht cilit vend apo popull i takojnë. Për një periudhë histori është Ibrahim Rugova, është Bacë Adem Demaçi, Adem Jashari dhe natyrisht është edhe Hashim Thaçi. Ky realitet nuk ndryshon, as sot e asnjëherë. Hashim Thaçi ishte kolos përballë prangave të një polici të dalë nga burokracia evropiane. Hashim Thaçi është kolos përballë një kriminelit dhe vrasësi juridik siç ishte Jack Smith që për para, famë dhe pozitë ia hoqi kokën Hashim Thaçit, deshi t’ia heq edhe Donald Trampit tash po lufton ta shpëtojë kokën dhe prapancën e vet. Shtet me dinjitet të rrënuar nga politikanë injorantë, antikombëtarë dhe mujsharë ndërkombëtarë!





# SA KA URGJENCË PËR FORMIMIN E QEVERISË SË RE TË KOSOVËS?

Gëzimi për numërimin e të gjitha votave të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë nuk zgjati shumë. Shumë shpejt nisi rinumërimi i disa votave, ndërsa ankesat e partive politike u bartën prej një gjykate në tjetrën. Në gjithë këtë situatë, pashmangshëm lindin dilemat nëse ka tendencë për zvarritje të procesit që duhet të rezultojë me formim të institucioneve të reja, apo gjithçka është brenda afateve ligjore

Prishtinë, 14 mars - Ka apo s'ka urgjencë për formimin e institucioneve të reja? Kjo është dilema në ditët e fundit në Kosovë. Publiku duket se është i ndarë, dhe secili grup i ka argumentet e veta. Ky disponim shpërfaqet edhe në bindjet e njohësve të çështjeve politike të cilët i kemi kontaktuar për këtë temë.

Për Bekim Salihun nga Instituti për Studime të Avancuara - GAP, situata aktuale e rinumërimit të votave dhe e ankesave nuk përbën risi, sepse rëndom partitë politike i kanë shfrytëzuar të gjithë mekanizmat ligjorë në dispozicion për të adresuar vërejtje ose ankesa të natyrave të ndryshme lidhur me

zgjedhjet. “Të dhënat nga zgjedhjet e kaluara tregojnë se periudha mesatare që i është dashur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për t'i certifikuar rezultatet ka qenë 21 deri në 30 ditë, kështu që ende jemi brenda margjinës së një praktike nga e kaluara”, thotë ai. Salihu beson se procesi, aktualisht, po zhvillohet me dinamikë normale, që mund të rezultojë me formim të qeverisë në formë të rregullt: “Kosova nuk është pa qeveri. Brenda 10 ditëve qeveria mund të kalojë në qeveri në detyrë, dhe si qeveri në detyrë nuk mund të procedojë më vetëm miratimin e ligjeve, përndryshe të gjitha funksionet e tjera i ka të lejueshme. Natyrisht që zgjedhjet mbahen për t'u formuar qeveria e re, dhe është

e rëndësishme të formohet, por aktualisht nuk ka mangësi ose hendek”.

## “Kosova nuk ka luks për të zvarritur procese”

Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit i fitoi Lëvizja Vetëvendosje (LV), e cila aktualisht është në pushtet, por nuk i ka votat e mjaftueshme për formimin e qeverisë së re. Kryeministri aktual Albin Kurti, njëherësh kryetar i LV-së, zotohet se do ta formojë ekzekutivin e ri, por pa treguar saktë se si. Zëra brenda partisë së tij përmendin mundësinë e një koalicioni me minoritetet joserbe dhe llogarisin në mbështetjen e ndonjë deputeti të partive të mëdha shqiptare,

ani pse ky skenar nuk konsiderohet se do të prodhojë stabilitet. Partitë e mëdha shqiptare kanë hedhur poshtë mundësinë e bashkëpunimit me Kurtin, madje kanë vendosur kushte edhe për arritjen e ndonjë koalicioni eventual me njëra-tjetrën. Vullnet Bugaqku, hulumtues i lartë në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), beson se, duke e marrë për bazë situatën gjeopolitike në botë, dinamikat brenda administratës së re në Shtetet e Bashkuara dhe zhvillimet e reja në Bashkimin Evropian, duket se ka mobilizim të tërësishëm të autoriteteve atje që të jenë të përgatitura dhe vigjilente karshi rrezikut dhe kërcënimeve, qoftë ndaj sigurisë, qoftë ndaj territorit.

## Bislimi takohet me ambasadorin e Austrisë, flasin për konstituimin e qeverisë

Prishtinë, 14 mars - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur ambasadorin e Austrisë në Kosovë, George Schnetzer. Sipas njoftimit të qeverisë, së

bashku biseduan për thellimin e marrëdhënieve të shkëlqyera në mes të Kosovës dhe Austrisë dhe për fuqizimin e bashkëpunimit të dyanshëm. Mes temave të diskutuara përgjatë takimit ishte edhe konstituimi i qeverisë pas

zgjedhjeve dhe hapat drejt formimit të institucioneve në legjislaturën e nëntë. Zëvendëskryeministri Bislimi e falënderoi ambasadorin dhe shtetin e Austrisë për partneritetin dhe mbështetjen e vazhdueshme.





# KËRKOHET QË KOSOVA T’I SHTOJË PËRPPJEKJET PËR DIGJITALIZIMIN E SHËRBIMEVE ONLINE

**PRISHTINË, 14 MARS** - Është mbajtur tryezë konsultative mbi rekomandimet e paraqitura në rezolutë për digjitalizimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale në Ballkanin Perëndimor, e cila derivon nga takimi i institucioneve të pavarura dhe autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Aty u përmendën rezultatet e tij, me ç’rast u theksua nevoja për një qasje rajonale, të unifikuar dhe gjithëpërfshirëse në hartimin e kuadrit të duhur

ligjor, për të siguruar të gjithë qytetarët të përfitojnë dhe përdorin shërbime digjitale të sigurta dhe të qasshme. Avokati i Popullit, Naim Çelaj, ka thënë se analiza e gjendjes aktuale e digjitalizimit të shërbimeve të administratës publike nxjerr në pah nevojën për rritjen e fokusit strategjik rajonal në avancimin e përpjekjeve për digjitalizimin e shërbimeve online. “Ka qenë një aktivitet shumë i rëndësishëm ku është folur për digjitalizimin e administratës publike dhe nevojën që e kanë shtetet për të

ndërmarrë masa me qëllim që të jenë të përgatitura për një të ardhme sa i përket zhvillimit të teknologjisë informative. Aty janë paraqitur përvojat e shteteve të rajonit dhe ka qenë interes imi si Avokat i Popullit se si reflektojnë apo si i qasen institucionet të drejtave të njeriut. Kemi parë që Shqipëria kishte bërë një hap para në drejtim të krijimit të strategjive për digjitalizim, por edhe të vet Avokatit të Popullit, e cila kishte dalë me një hetim të plotë lidhur me ndikimin që mund të ketë digjitalizimi në cenimin e të

drejtave të njeriut, që padyshim mund të jetë në disa fusha dhe u konstatua se fusha më e prekur mund të jetë ajo mbrojtja e të dhënave dhe privatësia si dy komponentë të rëndësishëm të të drejtave të njeriut. Natyrisht, përveç kësaj, u pa që përmes zhvillimit të digjitalizimit mund të preket edhe pjesa e diskriminimit, pra qytetarët mund të ndihen të diskriminuar, sidomos në çështje të konkursit për punësim”, tha Çelaj. Komisionarja për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-

Dërmaku, tha se procesi i digjitalizimit në Kosovë dhe në çdo vend është një proces që ka nisur tashmë dhe nuk do të përfundojë shpejt. Madje, sipas saj, nuk do të përfundojë ndoshta edhe pa pasoja. “Nëse ne si ligjvënës nuk do të vendosim rregulla të cilat duhet të zbatohen për t’i mbrojtur pikërisht të drejtat e njeriut”, tha ajo. Sogojeva-Dërmaku tha se digjitalizimi do të bëhet, por sfida më e madhe është pikërisht ndikimi i Inteligjencës Artificiale.



“Unë nuk mendoj se Kosova e ka luksin të humbë edhe shumë kohë në këtë aspekt, për faktin që edhe neve na presin mjaft obligime, sidomos obligimet që kemi në dialogun me Serbinë”, shprehet Bugaoku, duke përmendur edhe përpjekjet e administratës së presidentit amerikan Donald Trump për të arritur marrëveshje për t’i dhënë fund luftës në Ukrainë. Prandaj, ai e sheh të rrugës që “të ketë një dinamizëm dhe fokus të gjerë edhe për çështjen e rajonit të Ballkanit”.

## Kuvendi, “urgjencia e vetme”

Për Salihun e vetmja urgjencë duhet të ekzistojë në konstituimin e Kuvendit të Kosovës: “Janë rreth 800 milionë euro që Bashkimi Evropian i ka dedikuar për Kosovën dhe, siç u kuptua, BE-ja pret që këto marrëveshje, këto fonde, fillimisht të miratohen në Kuvendin e Kosovës për ta mundësuar procedimin tutje sipas natyrës së alokimit të tyre”. Kuvendi konstituohet kur të

zgjidhet kryetari dhe nënkryetarët e tij. LV-së, si fituese e zgjedhjeve, i takon ta propozojë emrin e kryetarit, por nëse kjo parti nuk çon përpara një emër, procesi ngrin në vend. Salihu nuk beson që do të ndodhë diçka e tillë meqë, sipas tij, ky skenar do ta dëmtonte partinë në fjalë për shkak se “mund të shihet si një lloj sabotimi, kundërshtimi, neglizhence, papërgjegjësie”. Bugaoku nuk sheh shumë nguti në këtë drejtim dhe beson se në këtë situatë përfiton qeveria aktuale: “Iu shkon për shtati

ministrave, zëvendësministrave, atyre që bartin ende pozicione të larta shtetërore, për faktin se gjithçka lidhet me krijimin e institucioneve, dhe meqë nuk po ka nguti në gjithë këtë situatën e pasigurisë me rezultate, me dyshimet dhe ankesat që po bëhen, dikush mund të mendojë dhe ta shohë edhe më afatgjatë qëndrimin në pushtet”. Megjithatë, Bugaoku përmend se shumë shpejt edhe këta zyrtarë mund të kenë kufizime, apo të mos mund të nënshkruajnë e ratifikojnë

marrëveshje ndërkombëtare, prandaj duhet të ekzistojë sa më parë një Kuvend që e mban logaridhënës ekzekutivin. Me ligjet e Kosovës brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultateve, presidentja e vendit duhet ta thërrasë mbledhjen konstituive të Kuvendit të Kosovës. Nëse zgjidhen kryetari dhe nënkryetarët, atëherë Vjosa Osmani duhet të kërkojë nga partia fituese, LV-ja në këtë rast, ta propozojë mandatarin për formimin e qeverisë. Deri atëherë të gjithë sytë janë te KQZ-ja!

## Abdixhiku takon ambasadorin turk: Roli i Turqisë në sigurinë e Kosovës të thellohet më tutje

Prishtinë, 14 mars - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka pritur në takim ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili. Gjatë këtij takimi kryetari Abdixhiku dhe ambasadori

Angili diskutuan për zhvillimet e fundit në vend, në veçanti për procesin zgjedhor të 9 shkurtit dhe qëndrimet e LDK-së lidhur me këtë temë. Kryetari Abdixhiku kërkoi që roli i Turqisë në sigurinë

e Kosovës të thellohet dhe më tutje dhe se bashkëpunimi ndërshtetëror të vazhdojë në nivelet më të larta të sigurisë. Në takim u diskutua edhe për mundësitë e

bashkëpunimit dhe për thellimin e raporteve mes dy vendeve, ndërsa kryetari Abdixhiku shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vazhdueshme që Turqia i ka dhënë Kosovës ndër vite.



## Kos: Shqipëria ka shënuar përparim shumë të mirë në rrugëtimin drejt BE-së

TIRANË, 14 MARS - Komisionarja e Bashkimit Evropian për Zgjerimin, Marta Kos, tha në Tiranë se Shqipëria ka ecur vërtet shumë mirë në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian. Këto komente komisionerja Kos i bëri në Tiranë në një konferencë shtypi me kryeministrin Edi Rama. Në tetor të vitit të kaluar

Shqipëria hapi bisedimet për grup-kapitujt e parë, që njihen ndryshe si themeloret, dhe që janë, po ashtu, të fundit që mbyllen. Në muajin dhjetor u hap dhe grup-kapitulli i dytë që lidhet me politikën e jashtme. Brenda gjashtëmuajorit të parë të këtij viti parashikohet dhe hapja e dy grup-kapitujve të tjerë dhe deri në

fund të 2025-s parashikohet që bisedimet të kenë përfshirë të gjithë grupkapitujt. Kryeministri Edi Rama përsëriti se ambicia e qeverisë së tij është që bisedimet të mbyllen brenda vitit 2027 e që deri në vitin 2030, Shqipëria të jetë bërë pjesë e Bashkimit Evropian. Komisionarja e Zgjerimit



## MUSLIU: BEOGRADI VAZHDON T'I TRAJTOJË SERBËT E KOSOVËS SI NJË MJET POLITIK

PRISHTINË, 14 MARS - Beogradi vazhdon t'i trajtojë serbët e Kosovës si një mjet politik, duke i instrumentalizuar ata për qëllime të brendshme dhe gjeopolitike. Kështu ka shkruar eksperti i sigurisë, Agim Musliu, në platformën "X". Ai tha se qeveria në Beograd po i keqpërdorë serbët e Kosovës. "Beogradi vazhdon t'i trajtojë

serbët e Kosovës si një mjet politik, duke i instrumentalizuar për qëllime të brendshme dhe gjeopolitike. Në vend se t'i ndihmojë ata të integrohen dhe ta përmirësojnë jetën e tyre, regjimi i Vuçiçit i përdorë ato si pretekst për tensione dhe destabilizime", tha Musliu. Ai tutje thekson se në protestat në vazhdim pret që presidenti

serb Aleksandar Vuçiç të vrasë një serb të Kosovës vetëm për ta siguruar vendin e tij në Beograd. "Presion mbi komunitetin serb për ta shmangur integrimin, krijimi i krizave artificiale për ta penguar dialogun, frikësimi i liderëve vendorë që kërkojnë bashkëpunim me institucionet e Kosovës. Serbët e Kosovës meritojnë liri të plotë për të

zgjedhur të ardhmen e tyre pa ndërhyrjen e Beogradit! Në protestat e vazhdueshme pres që Vuçiçi të vrasë një serb të Kosovës vetëm për të siguruar vendin e tij në Beograd. Dhe kjo nuk është aspak befasuese, duke marrë parasysh vrasjen e gjashtë të rinjve në Pejë në vitin 1998 - rasti 'Panda', ka shkruar Musliu.



## QEVERIA MBAN MBLEDHJE ELEKTRONIKE, MIRATON TRI VENDIME

PRISHTINË, 14 MARS - Qeveria e Republikës së Kosovës ka zhvilluar një mbledhje elektronike në të cilën ka aprovuar disa vendime. Përmes një njoftimi për medie bëhet me dije se në mbledhje është aprovuar "Udhëzimi Administrativ për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve". "Qeveria e Republikës së Kosovës ka zhvilluar një mbledhje elektronike në të cilën ka: 1. Aprovuar

Administrativ për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve. 2. Ndryshuar dhe plotësuar vendimin e Qeverisë Nr. 03/251 të datës 12 mars, me të cilin ka emëruar Komisionin Ad hoc për vlerësimin profesional për praninë në pozitën e lartë të kategorisë drejtuese: 'Kryeinspektor Shëndetësor në Inspektoratin Shëndetësor'. Sipas këtij ndryshimplotësimi, anëtari Avni Kastrati, drejtor ekzekutiv i ASK-së,



zëvendësohet me Anita Kalanderin, sekretare e Drejtësisë. 3. Ndryshuar dhe

plotësuar vendimin e Qeverisë nr. 05/251 të datës 12 mars 2025, me të cilin është emëruar Komisioni Ad hoc për vlerësimin profesional për praninë në pozitën e lartë të kategorisë drejtuese: 'drejtor ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale'. Sipas këtij ndryshimplotësimi, anëtari Avni Kastrati, drejtor ekzekutiv i ASK-së, zëvendësohet me Anita Kalanderin, sekretare e Drejtësisë, ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

## PROKURORIA AUTORIZON POLICINË T'I NISË HETIMET NDAJ SAMI KURTESHIT



Prishtinë, 14 mars - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka autorizuar Policinë e Kosovës që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme hetimore për anëtarin e Lëvizjes Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Sami Kurteshi, i cili ditë më parë ka bërë disa deklarata të papranueshme ndaj medieve. Kështu ka konfirmuar për

"Telegrafi"-n zyra për medie e Prokurorisë Themelore në Prishtinë. "Lidhur me pyetjen tuaj të cilën e keni parashtruar ju njoftojmë se Prokuroria Themelore në Prishtinë ka autorizuar Policinë e Kosovës që të ndërmarrin veprimet e nevojshme hetimore", thuhet në përgjigjen e tyre. Edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka reaguar

ashpër ndaj deklaratave të papranueshme dhe fyese të anëtarit të LV-së në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Sami Kurteshi, ndaj medieve. AGK-ja ka kërkuar nga Lëvizja Vetëvendosje të sigurojë që përfaqësuesi i saj në KQZ të përmbahet nga gjuha fyese dhe kërcënuese ndaj medieve dhe të mos pengojë punën e gazetarëve.

## Sorenseni në javën e ardhshme pritet ta vizitojë Kosovën

PRISHTINË, 14 MARS - Emisari evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen, pritët që javën tjetër ta vizitojë Kosovën. Klan Kosova ka marrë vesh se

ai pritët të qëndrojë në vendin tonë mes 18 dhe 19 marsit. Lajmin për vizitën e parë të diplomatit danez në Kosovë e dha ditë më parë edhe

gazetari i "Klan Kosovës", Besnik Tahiri, gjatë emisionit "Info Magazine". Kjo do të jetë vizita e parë e diplomatit danez në Prishtinë, i cili mori detyrën

e emisarit për dialogun e Brukselit më 1 shtator të vitit të kaluar. Këtë pozitë për gati pesë vjet e mbajti sllovaku Miroslav Lajčak.





# Sekretari i përgjithshëm i RCC-së në Prishtinë takon liderët e vendit për ta forcuar bashkëpunimin rajonal



**EPOKA ERE**      **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 14 MARS** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u takua të premten me sekretarin e ri të përgjithshëm të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Amer Kapetanovic, për të diskutuar mbi bashkëpunimin rajonal dhe integrimin ekonomik të rajonit. Procesi i Berlinit, Tregu i Përbashkët Rajonal (CRM), si dhe Agjenda e Gjelbër ishin ndër temat kryesore të diskutimit. Kryeministri e uroi sekretarin e përgjithshëm për detyrën e re dhe ritheksoi mbështetjen e Kosovës për RCC-në për promovimin e bashkëpunimit në rajon.

Duke potencuar rëndësinë e barazisë në organizatat rajonale, kryeministri nënvizoi nevojën për një përfaqësim të drejtë në pozitë drejtuese dhe në stafin e RCC-së dhe inkurajoi organizimin e më shumë aktiviteteve të RCC-së në Prishtinë. Kryeministri shprehu përkushtimin e Kosovës ndaj Planit të Veprimit CRM2 dhe theksoi rëndësinë e progresit në zbatimin e marrëveshjeve të mobilitetit të arritura në kuadër të Procesit të Berlinit në mënyrë që ato të sjellin përfitime konkrete për qytetarët. Agjenda e Gjelbër duhet të sigurojë një tranzicion të drejtë dhe, në këtë drejtim, duhet të garantohet qasje e barabartë

në mekanizmat e financimit. “Që nga 1 janari i këtij viti Kosova ka filluar zbatimin e njëanshëm të marrëveshjes për lëvizjen e lirë me letërnjoftime me Bosnjë-Hercegovinën, e cila ka rritur lëvizshmërinë e qytetarëve të Bosnjës drejt Kosovës. Ky vendim kontribuon në rritjen e mobilitetit të qytetarëve dhe bashkëpunimin rajonal. Kryeministri theksoi rëndësinë që Bosnjë-Hercegovina ta ratifikojë marrëveshjen për lëvizjen e lirë me letërnjoftime, si një obligim i marrë nga Procesi i Berlinit dhe në funksion të rritjes së lëvizshmërisë në mes të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës, por edhe në

funksion të thellimit të bashkëpunimit e integritetit ekonomik të rajonit”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Një ditë më parë edhe presidentja Vjosa Osmani ka pritur në takim sekretarin e përgjithshëm të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Amer Kapetanovic. Gjatë takimit presidentja Osmani diskutoi për angazhimin e Kosovës për bashkëpunimin rajonal si hap kyç për avancimin e gjithë rajonit dhe një kontribues për stabilitet dhe progres. Ajo vlerësoi nismat rajonale të cilat po kontribuojnë në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet shteteve fqinje në rajonin tonë, me ç’rast potencoi rëndësinë e mundësive të barabarta pa pengesa

procedurale apo politike. Duke folur për Procesin e Berlinit, Osmani theksoi nevojën për të punuar edhe më shumë për rikthimin e fokusit në tema të interesit të veçantë, siç është zbardhja e fatit të personave të zhdukur me dhunë gjatë luftërave të fundit në Ballkanin Perëndimor. Më tutje, presidentja Osmani theksoi rëndësinë jetike të investimit në fuqizimin e vajzave dhe grave, duke e cilësuar këtë si një parakusht për rritjen e mirëqenies dhe avancimin e zhvillimit të rajonit. Gjithashtu, Osmani theksoi se Kosova ka konfirmuar rolin e saj konstruktiv në rajon dhe riafirmoi angazhimin për integrimin e plotë në kuadrin rajonal.

# Komisioni i Venecias miraton opinionet për projektligjet e reformës në drejtësi, Qorrolli e vlerëson hap historik

**EPOKA ERE**      **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 14 MARS** - Gjatë Sesionit të 142-të Plenar të Komisionit të Venecias janë miratuar tri opinione ligjore për projektligjet e reformës në drejtësi në Republikën e Kosovës. Zëvendësministri i Drejtësisë, Vigan Qorrolli, ka thënë se ky miratim ka rëndësi të jashtëzakonshme për procesin e aprovimit të këtyre projektligjeve, të cilat do të reformojnë thelbësisht sektorin e drejtësisë, duke e përafëruar atë me standardet më të avancuara ndërkombëtare. “Ky është një moment historik, një dëshmi se drejtësia në Kosovë po kalon nga një periudhë tranzicioni në një fazë të konsolidimit të saj si shtyllë e pavarur dhe e pakompromis e shtetit të së drejtës. Ky miratim nuk është thjesht një hap procedural, është një fitore politike, juridike dhe morale për qytetarët e Republikës së Kosovës. Reforma në drejtësi



nuk është luks dhe as thjesht një domosdoshmëri teknike. Është themeli mbi të cilin ndërtohet një shoqëri e drejtë dhe e lirë”, ka thënë ai.

Qorrolli ka theksuar se drejtësia e pavarur është garancia për liritë dhe të drejtat e qytetarëve, për barazinë para ligjit dhe për ndërtimin e një shteti që i

shërben qytetarit, jo interesave të grupeve apo individëve të fuqishëm. Opinione të Komisionit të Venecias kanë shtjelluar

projektligjet për Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Projektligjit për Akademinë e Drejtësisë, projektligjin për Rekrutimin, Vlerësimin e Performancës, Kontrollin e Integritetit dhe Statusin e gjyqtarëve/prokurorëve si dhe Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të cilat sigurojnë hapin e mëtejshëm për realizimin e këtyre reformave. “Kosova po dëshmon se është një shtet që nuk ndërton vetëm institucione, por ndërton drejtësi. Një shtet që e vendos ligjin mbi interesat e individëve dhe fuqinë e së drejtës mbi të drejtën e fuqisë. Ky është vetëm fillimi. Reforma në drejtësi nuk përfundon këtu. Ndërtimi i një drejtësie të pavarur kërkon guxim, përkushtim dhe besim. Dhe ne jemi të vendosur ta çojmë këtë proces deri në fund, me ndershmëri, profesionalizëm dhe përkushtim të plotë ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës”, ka thënë Qorrolli.



## Sot bojkotohen supermarketet

**PRISHTINË, 14 MARS** - Iniciativa "Kosova bojkoton" ka bërë thirrje për bojkotimin e të gjitha supermarketeve në Kosovë më 15 mars për shkak të ngritjes së çmimeve. Aktivistët e iniciativës kanë shpalosur të enjten një pankartë me mbishkrimin "15 mars, Kosova bojkoton të gjitha supermarketet". Xhevat Kastrati, anëtar i kësaj iniciative, u ka bërë thirrje qytetarëve t'i bashkohen kësaj iniciative për bojkotimin e marketeve.

Ai ka thënë se përmes bojkotit tregojnë fuqinë e tyre blerëse dhe se dërgojnë një mesazh te marketet dhe qeveria për pakënaqësinë e tyre për rritjen e çmimeve. "Ne jemi grupi 'Kosova bojkoton'. Jemi grup joformal qytetar që kemi marrë si nismë punën e rritjes së çmimeve. Kjo është një lloj proteste përmes bojkotit që jemi duke e realizuar. Thirrja për qytetarët është që t'i bashkohen nismës tonë

dhe ta ngrehim zërin përmes një bojkoti, duke treguar fuqinë tonë blerëse. Kur të gjithë bashkoheni në bojkot, dërgojmë një mesazh te marketet dhe qeveria se jemi shumë të pakënaqur dhe e bëjmë një lloj presioni shoqëror për të sjellë një reagim", ka thënë Kastrati. Këso lloj nismash për bojkotimin e marketeve janë duke u zhvilluar edhe në vendet e rajonit për shkak të rritjes së çmimeve.



## ASK-ja: Çmimet e konsumit shkuan në 1,7 % vjetore dhe 0,4 % mujore

**EPOKA  
ERE****Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 14 MARS** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin shkurt 2025, vitit bazë 2015=100. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,7 % në muajin shkurt 2025, krahasuar me muajin shkurt 2024. Inflacioni mujor ishte 0,4 % në muajin shkurt 2025.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,7 % në muajin shkurt 2025 krahasuar me muajin shkurt 2025. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e

COICOP-it: kafja, çaji dhe kakao (14,9 %), vajrat dhe yndyrnat (9,8 %), shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (7,6 %), gazetat, librat dhe materialet për zyra (6,2 %), mishi (5,6 %), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (5,5 %), shërbimet financiare (5,2 %), qumështi, djathi dhe vezët (4,6 %), pijet alkoolike (4,1 %), veshje (3,6 %), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (3,5 %), kujdesi personal (3,3 %), shërbimet hoteliere (3,2 %), duhani (2,9 %), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (2,8 %), pajisje shtëpiake (2,5 %), perimet (2,4 %), buka dhe drithërat (1,8 %), shërbimet ambulantore (1,8%), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (1,6 %) dhe pemët (1,4 %) me një ndikim të



përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,4 për qind në IHÇK.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (-6 %), biletat e fluturimeve (-5,5 %), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal, (-5,1 %) dhe blerja e automjeteve (-1,9 %) dhe blerja

e automjeteve (-1,6 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,7 për qind në IHÇK.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,4 % në muajin shkurt 2025 krahasuar me muajin janar 2025. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë

periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pemët (3,3 %), kafja, çaji dhe kakao (2,3 %), perimet (2,1 %), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (1,8 %), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (1,7%), shërbimet ambulantore (1,1 %), shërbimet hoteliere (1,1 %), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (1 %), ndryshimet e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të disa nëngrupe me një ndikim të vogël në IHÇK. me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,7 për qind në IHÇK.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: biletat e fluturimeve (-11,4 %) dhe energjia elektrike (-3,8 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,3 për qind në IHÇK.

## Rritet numri i fluturimeve dhe i udhëtarëve me avion

**PRISHTINË, 14 MARS** - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e transportit dhe telekomunikimit për muajin janar 2025.

Në muajin janar 2025 numri i fluturimeve të realizuara ishte 1 138 ose 14,3 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i udhëtarëve në total ishte 343 606 ose 19,6 % më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të



kaluar (Janar 2024).

Në muajin janar 2025 numri i udhëtarëve ishte 4 048 ose 22,1 % më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa sasia e mallrave të transportuar në neto ton ishte zero. Në muajin janar 2025 numri i përdoruesve të rrjetit telefonik fiks ishte 67 851 ose 2,2 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa trafiku i realizuar (në minuta)

ishte 1 886 976 ose 38,2 % më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (janar 2024).

Në muajin janar 2025 numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1 526 830 ose 1 % më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i përdoruesve me kontratë (Postpaid) ishte 313 119 ose 7 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

## Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e implantit të ujërave të zeza Mitrovicë - Vushtrri

**MITROVICË, 14 MARS** - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes për ndërtimin e implantit të ujërave të zeza në Mitrovicë - Vushtrri, një projekt me vlerë prej 39.3 milionë eurosh. Ky investim ka për qëllim trajtimin e ujërave të zeza sipas standardeve bashkëkohore, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe

mbrojtjen e burimeve ujore. Ky projekt është mundësuar me mbështetje financiare nga institucionet ndërkombëtare: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) me 13,5 milionë euro, Banka Evropiane për Investime (BEI) me 19,8 milionë euro, WBIF me një grant prej 5 milionë eurosh, EBRD me një grant prej 700 000 eurosh dhe SECO - FOPIP me një grant prej 300 000

eurosh.

Zona e shërbimit do të përfshijë Mitrovicën dhe Vushtrrinë, me mundësi përfshirjeje edhe të pjesës veriore. Ky projekt ka një rëndësi të veçantë për përmirësimin e trajtimit të ujërave të zeza, që do të ndihmojë në reduktimin e ndotjes së lumenjve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët e Mitrovicës.





DEMONSTRATAT E VITIT 1981 NË KOSOVË, SIPAS REVISTËS GJERMANE “DER SPIEGEL” (2)

# DEMONSTRATAT E VITIT 1981 NË KOSOVË... JUGOSLLAVIA PA PANTALLONA TË GJERA (HAREMI)



Shkruan: Mr. sc. Naim J. KRASNIQI

“Pas shtypjes me dhunë të rajonit të Kosovës, Partia pastron: armiqtë përreth saj.” Për më shumë se një muaj, qeveria e Jugosllavisë dhe mediat e saj fshehën të vërtetën për trazirat më të rënda të pasluftës në shtetin shumëkombësh: kryengritjen e shqiptarëve në rajonin e Kosovës. “Një provincë me madhësi të Schleswig-Holstein u bllokua nga policia dhe ushtria nga bota e jashtme në fund të marsit (dhe tani është ende shumë e vështirë për të shkuar atje). Ndërkohë, në shtypin jugosllav raportohej për mundësitë e shkëlqyera turistike në Kosovë. Duke qenë se gazetatat e Jugosllavisë ende nuk e kishin mbushur boshllëkun e informacionit, organi i Partisë në Zagreb, “Vjesnik”, sugjeroi sërish për ata që kërkonin pushime, “sidomos për grupet e shkollave”, të vizitonin 2500 shtretërit e hoteleve të këtij rajoni.” Kësaj propagande të mediave (me siguri të sugjeruar nga politika), autori i analizës i përgjigjet kështu: “Po aty, është nisur një gjueti shtrigash: Pasi zona u qetësua me forcë dhe represion të forcave ushtarake dhe të milicisë (sipas zyrtarëve: ka 11 të vdekur), dhe që Partia po pastron (po pastrohet nga

armiqtë në radhët e saj). “Unë kurrë nuk do të kisha menduar se armiku mund të mashtrojë kaq shumë të rinj,” shprehu habinë kryetari i partisë të Provincës Bakalli, një ish-mësues, i cili llogaritej si i suksesshëm, me një seri arrestimesh të intelektualëve shqiptarë pak para vdekjes së Titos vitin e kaluar, që kishin nxitur urrejtje ndaj popullit...(...) Sidomos në shkolla, Bakali zbuloi një “pikë mbështetjeje të irredentizmit shqiptar”, pra përpjekje për t’u bashkuar me Republikën Popullore të Shqipërisë. Ky proces vazhdon, sepse nxënësit dhe studentët

“nuk ngurrojnë të kryejnë provokime të reja dhe forma të tjera të veprimtarisë armiqësore” (duke vazhduar në fjalimin e tij duke informuar komunistët e Kosovës me atë që kishte ndodhur sipas tij). Por, sipas disa raporteve, deri atëherë kishte një shumicë të 232 të arrestuarve (në prill 1981). Agjentët e shtetit dhe njësitë ushtarake që qëndronin në gatishmëri për të sulmuar, janë tërhequr vetëm në oborret e brendshme të godinave të tyre, po vëzhgojnë rrugët dhe rrugicat e qyteteve të Kosovës, sidomos të rinjtë e kombësisë shqiptare në kryeqytetin rajonal të Prishtinës. Gazeta “Politika



Foto: Një bujk shqiptar i Kosovës i arrestuar, ku thotë: “... Të gjithë do të dalim jashtë Jugosllavisë...”





Foto: (Faksimil i ndarjes së sferave të interesit në mes Lindjes dhe Perëndimit, për më shumë shih Naim Krasniqi “Demonstratat e vitit 1981 në Kosove”, Prishtinë 2011, fq.29)


Ekspres” e Beogradit denoncoi “një grup prej rreth 20 djemsh dhe vajzash që janë shfaqur për tri mbrëmje radhazi në veshje tradicionale popullore me kapelen (Plisine) të bardhë, duke kaluar në bulevardin e Prishtinës, të njohur si rruga Marshall Tito”.(...) Nën “shokun traumatik” (“Vjesnik”-u kroat shkruante - N.K.) të kryengritjes në Kosovë, fajtorët nuk kërkojnë vetëm aty, por edhe shumë grupe të errëta të nxitjes armiqësore akuzohen: emigrantët shqiptarë në Gjermani, Belgjikë dhe Amerikë; mësuesit (është fjala për profesorët që ligjëronin në Universitetin e Prishtinës -N.K.) nga Republika Popullore e Shqipërisë që ishin lejuar të ligjëronin në Prishtinë; dhe përfundimisht fajtorë janë edhe dy superfuqitë, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik. Pra, aq larg shkonte gazeta “Vjesnik”, sa e gjithë bota ishte e përfshirë në organizimin e këtyre demonstratave. “Anëtari i Presidencës së Beogradit, Fadil Hoxha, (anëtar i Kryesisë së Jugosllavisë -N.K.) me origjinë shqiptare, e pyet qeverinë në Tiranë nëse dëshironte të provokonte sulme të reja për luftë”. Shteti fqinj, i cili është i vetmi shtet evropian që nuk ka nënshkruar Aktin e Helsinkit, kërkon “vetëvendosje” për bashkatdhetarët e tij nën sundimin serb. Organi i Partisë shqiptare “Zëri i Popullit” pretendonte se Tito vetë kishte

premtuar në vitin 1946 ribashkimin e Kosovës me atdhenë shqiptar.“ Ky konstatim është i përsëritur pothuajse në çdo periudhë. Mund të jetë e vërtetë që kanë diskutuar, por sipas të gjitha analizave të asaj kohe, çështja e kufijve ishte përcaktuar në Jaltë (Tetor 1944, apo siç njihet marrëveshja „Fiti-Fiti“), ku „...ishin ndarë interesat gjeostrategjike mes Lindjes komuniste dhe Perëndimit...“, ku Jugosllavia ishte ndarë në zona interesi 50:50% për të dy blloqet. (Më gjerësisht shih „Diplomacia“ Kisinger, po ashtu Dedier „Interesat e sferave“, e po ashtu edhe shumë botime të tjera, ku për Shqipërinë si shtet dhe shqiptarët në përgjithësi as që ishte diskutuar.) Prandaj, Enveri me Titon mund të kenë mundur të bisedojnë, por nuk ishin ata që vendosnin për çështje të kufijve. Gjatë kësaj kohe kishte shumë ide dhe plane rreth rregullimit të çështjes së Ballkanit. “Tito kishte marrë miratimin e Moskës për aneksimin e Kosovës; por kur ai dëshironte të bashkonte gjithë Shqipërinë dhe Bullgarinë në një “Federatë Ballkanike”, ndodhi ndarja midis Moskës dhe Beogradit në vitin 1948“. Pra, prishja e marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Moskës, edhe atëherë kur Titoja (mendoj se kishte një përkrahje nga Perëndimoret, e sidomos pas zgjedhjes së Krizës së



Tireshtes), ai shfaqte pretendime për kompensim në emër të Federatës Ballkanike. Stalini e kuptoi këtë dhe nuk e përkrah, dhe nga ana tjetër filloi sulmet kundër Titos në baza ideologjike, d.m.th. komuniste, ku Titoja paraqitej si shkatërrues i sistemit socialist. “Sot, sipas supozimeve të funksionarëve të Beogradit, sovjetikët mund të mbështesnin Shqipërinë, duke mbështetur pretendimet e saj për Kosovën. Po ashtu, nëse mbështesin Bullgarinë për të rikuperuar Maqedoninë, që sot është një provincë e Jugosllavisë, kjo do t’i jepte Bashkimit Sovjetik një urë tokësore për në Adriatik.” Analisti vazhdon me këto analiza, sa që konstaton se: “Zëri i Popullit” (Organi zyrtar i PPSH) i Shqipërisë përgatiti një ofertë në drejtimin tjetër, duke paraqitur një skenar të luftës: Në rast të një sulmi sovjetik ndaj Jugosllavisë, Shqipëria do t’i ofronte ndihmën pasuesve të Titos.” Këtë teori autori i analizës e mbështet edhe me konstatimet e dy publicistëve amerikanë. “Disa publikime të njohura, nga gazetarë-analistë amerikanë, Cyrus L. Sulzberger, pretendojnë se informacioni për ngjarjet në kufirin jugor të Jugosllavisë, në rajonin e Kosovës, ka mbërritur dhe ka qenë një nxitje e drejtpërdrejtë nga Moska. Sulzberger gjithashtu pohon se ndoshta dikush ka nxitur trazirat në Kosovë. Para demonstratave masive, ndodhi një zjarrvënie në Patriarkanën Ortodokse të Pejës, e cila ndodhi si një provokim për pakicën serbe në Kosovë.” Analisti shkon duke përmendur rastet që kishin ndodhur dhe pretendon se kanë ndikuar në revoltimin e shqiptarëve, por konstatimi i tij është shumë i pabazuar, sepse zjarri në Patriarkanën e Pejës kishte ndodhur pas zhvillimeve dramatike të rebelimit. Ky zjarr

kishte ndodhur dikur ndërmjet datave 5 dhe 6 Prill, kur në Kosovë mbretëronte gjendja e jashtëzakonshme, që nuk lejonte asnjë lëvizje. Vetëm policia dhe ushtria jugosllave kontrollonin tërë territorin e Kosovës. Prandaj, Dollanci në Konferencën e parë për shtyp të mbajtur më 7 Prill 1981, kur pyetet nga një gazetar, ai u përgjigj në mënyrë të prerë se: „... kjo s’ka asgjë të përbashkët me demonstratat...” (shih N.K. „Demonstr...“, fq. 105) “Më pas shpërtheu një thashethem, se një vajzë shqiptare ishte përdhunuar nga serbët gjatë një shfaqjeje sportive-politike, ‘Stafeta e Rinisë’. (Këtu bëhet fjalë për incidentin që kishte ndodhur në Kaçanik me rastin e përcjelljes së Stafetes për në Maqedoni, më 26 Mars 1981. N.K.) Kjo e bëri që edhe shqiptarët myslimanë (...) të Kosovës të ndiheshin të provokuar. Ndërkohë që në Prishtinë mijëra demonstrues po përpiqeshin të pushtonin ndërtesën e Partisë (është fjala për ndërtesën Komitetit Krahinor të LKK), dhe në shumë fabrika po bëheshin greva, në shumë fshatra shqiptarët sulmuan shtëpitë serbe dhe ngacmuan vajzat që vishnin pantallona të gjera.” (Pjesa e fundit e këtij pasusi është e pasaktë, sepse gjatë periudhës 11 Mars deri më 3 Prill nuk ka asnjë të dhënë për sulme ndaj qytetarëve serbë apo të kombësive të tjera. Përleshjet ishin në mes demonstruesve dhe forcave ushtarake të pushtetit. Ky përshkrim është për demonstratën e 26 Marsit të vitit 1981, në Prishtinë, kur pushteti dhe Partia kishin organizuar një manifestim për pritjen e Stafetes, ndërsa studentët, të revoltuar për burgosjet që kishin ndodhur, kishin organizuar një formë protestimi. Por reagimi i forcave të rendit bëri që kjo të



*Pamje nga gatishmëria e demonstruesve për realizimin e kërkesave të tyre dhe nga ana tjetër rrethoja ushtarake – policore e regjimit<sup>195</sup>*


kalonte në një demonstrim të ashpër, ku turmave të studentëve u bashkuan edhe punëtorët e ndërmarrjeve të ndryshme të Prishtinës. Represioni dhe dhuna që u përdor nga organet e rendit treguan se komunistët kosovarë nuk pranonin një revoltim të tillë dhe filluan aksionet e ndjekjeve policore dhe politike kundër studentëve dhe pjesëmarrësve të tjerë. – N.K.).

### Parashikimi i Sulzberger-it për këto ngjarje

Kjo analizë vazhdon me teoritë e analistit dhe njohësit të rrethanave politike, amerikanit Sulzberger, ku sipas tij: “Duket se ndihmësit kishin përgatitur me kujdes skenarët e situatës.

Sulzberger beson se ngjarjet përbëjnë një provë të qartë për Bashkimin Sovjetik, për të testuar stabilitetin dhe vëllazërimin – bashkimin kombëtar të Jugosllavisë pas Titos”, ku pretendohet se shkatërrimi i Jugosllavisë ishte i skicuar, dhe këtë e vërtetonte deklarata e Fadil Hoxhës, kur deklaronte: “Se urrejtja midis grupeve kombëtare është nxitur edhe nga udhëheqësia e Beogradit. Anëtar i Presidencës, Hoxha, pohon se ka lidhje midis dëshirave të shqiptarëve për bashkim kombëtar dhe ambicieve të mëdha bullgare për Maqedoninë.” “Në të njëjtën kohë, Beogradi publikoi rezultatin e një censusi në një tjetër rajon të Serbisë, te Vojvodina, i populluar nga hungarezët: Numri i hungarezëve ka rënë ndjeshëm, një arsye mjaft e mirë për Republikën e Hungarisë për të kërkuar ndihmë për bashkëkombësit e saj jashtë kufijve të Serbisë.” Kështu që erdhën reagimet e para nga Hungaria, një shtet fqinje i Jugosllavisë, ku Budapesti akuzon Beogradin për asimilimin e grupeve të pakicave jo-sllave. Kur gazeta hungareze “Nepszabadsag” raportoi për përdorimin e tankeve në Kosovë, Beogradi shpërtheu me zemërim: Kush përmend përdorimin e tankeve, harrojnë se ‘herë pas here rendi kthehet me ndihmën e tankeve të huaja’ – duke aluduar për ndërhyrjen sovjetike në Hungari në vitin 1956 (të cilën Tito e kishte mbështetur, pasi udhëheqësi sovjetik, Hrushcov, e kishte arsyetuar intervenimin tek Titoja se Qeveria hungareze dëshironte të mbrojtë pakicën hungareze në Jugosllavi, prandaj kjo konsiderohej si një rrezik për zonën e pakicës hungareze në Vojvodinë).” Analiza përfshin situatën e

përgjithshme në Jugosllavi, ku shkruan: “Një vit pas vdekjes së Titos, Jugosllavia e gjen veten të rrethuar nga armiqtë e jashtëm dhe të minuar nga armiqtë e brendshëm. Nervozizmi është rritur edhe në pjesë të tjera të vendit: Një valë arrestimesh janë shpërndarë në Kroaci në veri, ndërsa në Vranje, një qytet në kufi me Bullgarinë, policia ka qëlluar mbi një djalë që kishte vendosur një poster kundër regjimit. Pas këtij incidenti, radio dhe shtypi kanë heshtur, ndërsa populli ka folur për një betejë midis grupeve të rezistencës dhe agjentëve të shtetit.” Duke bërë analiza të tilla dhe duke u përpjekur të gjenin organizatorët e rebelimit të 11 marsit të vitit 1981, “Der Spiegel” vazhdon me hulumtimet e saj duke përshtatur situatën edhe në republikat tjera e posaçërisht shkruan për pakënaqësitë e kroatëve dhe ngjarjet që ndodhnin atje. Ajo fillon duke analizuar nga “Pranvera Kroate 1970-71” e deri tani, ku përshtat dënimet e intelektualëve kroatë për bindjet e tyre politike, dhe shumë prej tyre kishin qenë pjesëmarrës në Luftën II Botërore, por më vonë nuk pajtoheshin me vijën politike të udhëhequr nga Lidhja Komuniste e Jugosllavisë dhe vetë Titoja. Ata nuk pajtoheshin se serbët dominonin në strukturat shtetërore në kuadër të Federatës Jugosllave. Ndërsa, autori i analizës së 17 Majit të vitit 1981, para opinionit gjermanofon, se si burgosej “fjala e lirë” në Kroaci, dhe do të vazhdonte edhe në Kosovë. Në artikullin “Bariu Ideal”, përshtatet se si pushtetarët jugosllavë deklarorin për ruajtjen e “Bashkim-Vëllazërimit”, por se në “grixhen tonë”, ka edhe të atillë që nuk pajtohen, prandaj duhet të ndëshkohen. (Vijon)





# ARMËPUSHIMI, KUSHTET E PUTINIT: JA 4 NYJET E NEGOCIATAVE (DHE KUSH PËRFITON)

Nga Lorenzo Cremonesi, Corriere della Sera

**1 Cila është pika më e diskutueshme e armëpushimit midis Ukrainës dhe Rusisë e propozuar nga amerikanët?**

Në themel të problemit janë dy vizione rrënjësisht të ndryshme të armëpushimit. Për ukrainasit, vota "po" e arritur të martën e kaluar në Arabinë Saudite ishte në thelb një mënyrë për të qetësuar marrëdhëniet me administratën Trump, pas krizës që shpërtheu gjatë takimit të 28 shkurtit midis Zelensky, presidentit amerikan dhe zëvendëspresidentit të tij JD Vance. Nga ana tjetër, Putini nuk e braktis objektivin kryesor për të cilin nisi pushtimin e armatosur më 24 shkurt 2022. Rusia ende sot synon të kontrollojë Ukrainën dhe ta bëjë atë një shtet vasal. Çdo ndalim i luftimeve që do të forconte sovranitetin e Ukrainës dhe do ta lidhte atë me demokracitë perëndimore dhe NATO-n është një humbje për Putinin.

**2 A e mori Zelensky atë që donte?**

Tani për tani, po. Të mërkurën, amerikanët rifilluan ndihmën



ushtarake, e cila ishte ndërprerë që nga kriza e 28 shkurtit. Rihapja e bashkëpunimit me inteligjencën amerikane dhe dërgimi i raketave kundërajrore janë thelbësore për mbrojtjen e qiejve të Ukrainës dhe sigurimin e stabilitetit të frontit. E në ditët në vijim, i dërguari special i SHBA-së, Keith Kellogg, pritet në Kiev, ku pritet të finalizojë marrëveshjen për bashkëpunim në shfrytëzimin e burimeve minerale të Ukrainës. E gjithë kjo

ndihmon edhe në ngritjen e moralit të trupave, të cilët e kanë parë gjithmonë me lehtësim dhe shpresë ndihmën ushtarake amerikane dhe vazhdojnë të besojnë se tani për tani kontributet ushtarake të aleatëve evropianë nuk mund të zëvendësojnë ato amerikane për nga cilësia dhe sasia. Nga ana tjetër, Zelensky kishte hequr dorë nga kërkesa që kishte bërë që në fillim të konfliktit: që amerikanët, kundër hyrjes së Ukrainës në NATO, të paktën të ishin në

gjendje të ofronin "garanci sigurie". Mungesa e kësaj pike në armëpushim e ekspozon atë ndaj kritikave serioze të brendshme.

**3 Por çfarë ndodh me ukrainasit tani pas "po-së së kushtëzuar" ruse?**

Zelensky kishte reaguar me kënaqësi pas samitit të Jeddah, duke pretenduar se "tani topi është në fushën e Rusisë". Trump në fakt kishte pranuar propozimin e tij të kompromisit për një armëpushim 30-ditor, veçanërisht në Detin e Zi, në qiej, por edhe në fushat e betejës. Shpresa e tij është të bindë administratën e re në Uashington se faji për luftën nuk është Ukraina (siç kishte pretenduar Trump në vend të kësaj, duke e akuzuar atë si një "diktator jopopullor përgjegjës për konfliktin"), por një qëndrim i formësuar në ashtin imperialist të politikës ekspansioniste ruse. Por përgjigja e Putinit i ndërlikon gjërat dhe i detyron ukrainasit të rinisin shpjegimet e tyre.

**4 Çfarë dëshiron Putini?**

Presidenti rus po e kushtëzon fillimin e armëpushimit jo vetëm me mënyrën se si do të monitorohet, por mbi të gjitha kërkon që kushtet e paqes të bëhen të qarta tani. Me fjalë të tjera, Putin dëshiron të flasë

menjëherë për nevojën që ukrainasit të heqin dorë nga katër rajonet e pushtuara nga ushtarët rusë: Lugansk, Donetsk, Zaporizhzhia dhe Kherson. Përfshirë zonat e këtyre provincave që mbeten ende në duart e Ukrainës. Putini do të donte gjithashtu të bllokonte rifillimin e bashkëpunimit ushtarak amerikan me ukrainasit tani. "Nëse ukrainasit vazhdojnë të armatosen edhe gjatë armëpushimit, atëherë ata do të jenë në gjendje të luftojnë më mirë se më parë." Putini vendos fitoren totale ruse në rajonin e Kurskut përpara çdo marrëveshjeje. Në sytë e tij, armëpushimi nuk mund të fillojë nëse trupat ukrainase nuk tërhiqen në kufirin ndërkombëtar në zonën e Sumy. Putin dëshiron ta lidhë marrëveshjen për Ukrainën me rifillimin e marrëdhënieve dypalëshe midis Moskës dhe Uashingtonit. Dje ai foli edhe për mundësinë e nënshkrimit të marrëveshjeve ruso-amerikane për shfrytëzimin e burimeve ruse. Në leximin e tij, Evropa duhet të zbresë në një rol marginal. Në fund të fundit, vizioni i tij "neo-imperial dhe i shekullit të nëntëmbëdhjetë" korrespon- don me vizionin e Trump: fuqitë e mëdha diktojnë rregullat e politikës ndërk- ombëtare dhe shtetet më të vogla mund të përshtaten vetëm. Në këtë lexim, Moska synon të ketë kontroll të plotë mbi forcat e armatosura dhe sovranitetin ukrainas.







Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Ballkani u kthehet fitoreve në Superligë

**SUHAREKË, 14 MARS** - Skuadra e Ballkanit ka shënuar fitore në përballje me Ferizajn (2-1) në kuadër të javës së 25-të në Superligën e Kosovës në futboll. Në minutën e 18 Sunday Adetunji ka realizuar

golin e parë në ndeshje për 1-0. Pjesa e dytë ishte më e hapur dhe të dyja skuadrat shënuan nga një gol, kurse një tjetër gol u anulua nga VAR-i. Në minutën 70 Atedunji realizoi gol, por që u anulua

nga VAR-i dhe vetëm dy minuta më vonë. Antonio Ilieski barazoi shifrat në 1-1. Vendasit arritën ta rikthejnë epërsinë me golin e shënuar nga Adetunjit (76'), i cili u shënua në minutën e 76. Pas

kësaj fitore, Ballkani zë vendin e dytë me 43 pikë, teksa Ferizaj renditet i pesti me 32 pikë. Në ndeshjen e ardhshme therandasit luajnë në udhëtim te Llapi, teksa ferizajasit e presin Dukagjinin.



## Çdo përballje interesante në Superligën e basketbollit



**MITROVICË, 14 MARS** - Fundjava sjell duelet interesante në javën e 24-t të ProCredit Superligës. Kampionati për garat e rregullta po shkon drejt fundit. Çdo përballje është shumë e rëndësishme dhe interesante. Trepça - Vëllaznimi është një përballje interesante, me të dy skuadrat që synojnë të renditen sa më lart në renditje para garave të "play-off"-it. Mitrovicasit janë në pozitën e dytë së bashku me Sigal Prishtinën, me 15 fitore e tetë humbje, derisa kuqezinjtë në vendin e pestë me 11 fitore e 12 humbje. Të shtunën

zhvillohet derbi i qytetit në mes të Bashkimit dhe Proton Cable Prizrenit. Dy skuadrat janë në formë në ndryshme. Bashkimi është në vendin e parë me 16 fitore e shtatë humbje, ndërsa Proton Cable Prizreni në vendin e fundit me pesë fitore e 18 humbje. Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli është, po ashtu, një sfidë interesante. Prishtinasit kanë nëntë fitore radhazi në elitë në vitin 2025, derisa deri më tani kanë 15 fitore e tetë humbje, kurse therandasit kanë dhjetë fitore e 13 humbje, në vendin e gjashtë. Peja - Bora është, po

ashtu, një duel, ku të dy skuadrat luftojnë për fitore. "Verdhezinjtë" janë në vendin e katërt me 12 fitore e 11 humbje, ndërsa prishtinasit në vendin e shtatë me tetë fitore e 15 humbje.

### SUPERLIGA - Java 24

**Të shtunën takohen:**  
20:00 Trepça - Vëllaznimi  
20:00 Bashkimi - Proton Cable Prizreni

**Të dielën takohen:**  
20:00 Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli  
20:00 Peja - Bora

## Foda publikon listën e futbollistëve për dy ndeshjet kundër Islandës

**PRISHTINË, 14 MARS** - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Franco Foda, e ka bërë publike listën e futbollistëve që do t'i ketë në dispozicion për dy ndeshjet e "play-off"-it të Ligës së Kombeve kundër Islandës, që zhvillohen më 20 dhe 23 mars. Edhe kësaj radhe Foda, krahas

listës prej 26 futbollistëve, e ka përpiluar edhe listën e zgjeruar prej 9 futbollistëve. "Dardanët" fillojnë grumbullimin të hënën, ku stërvitjen e parë e zhvillojnë në orën 17:30. Paraprakisht në orën 12:00 në hotel "Emerald" Foda do të paraqitet në konferencë për medie.

### LISTA E FUTBOLLISTËVE

A.Saipi, A.Muriq, V.Bekaj, M.Vojvoda, F.Hadërgjonaj, A.Rrahmani, I.Krasniqi, L.Dellova, F.Aliu, A.Hoti, L.Paqarada, D.Rrudhani, D.Gallapeni, E.Krasniqi, E.Sahiti, V.Berisha, V.Demaku, E.Rexhbeçaj, L.Emërllahu, B.Zabërgja, L.Abdullahu, M.Rashica, F.Asllani, F.Muslija, A.Rrahmani, V.Muriqi.



## 'Ylli i javës', Aliu: Malisheva synon daljen në Evropë

**MALISHEVË, 14 MARS** - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 24-t në Albi Mall Superligë i është dhënë sulmuesit të FC Malisheva, Altin Aliu. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të

Shyqeri Salihu, Agim Xhakoli dhe Selajtin Jerliui. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e njëzet e katër t'i takojë Altin Aliu, i cili shënoi tre gola në fitoren 4-1 të Malishevës në ndeshjen kundër SC Gjilani. Pasi mori këtë çmim, Aliu u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: "Duke pasur parasysh që SC Gjilani ka

pasur ambiciet e veta, jemi përgatitur shumë për këtë ndeshje, sepse këto tri pikë na japin stabilitet për pjesën e sipërme të tabelës. Jemi përgatitur maksimalisht dhe çdo lojtar e tregoi shpirtin luftarak, andaj edhe dolëm pozitivë në këtë ndeshje. Që nga fillimi i sezonit Malisheva ka treguar ambiciet për dalje në Evropë dhe duke e pasur parasysh

kontingjentin e lojtarëve që kemi dhe atmosferën e mirë, do ta japim maksimumin që t'i arrijmë objektivat e klubit dhe suksesin tonë". "Është një ndjenjë e mirë që të shpallem 'Ylli i javës' dhe shpresoj që do ta marr edhe herë të tjera, sepse ky është një sukses i karrierës sime. Dua t'i falënderoj bashkëlojtarët, sepse pa kontributin e tyre nuk do ta



arrija ta fitoja këtë çmim", ka deklaruar Aliu për faqen zyrtare të FFK-së.



## Kosovës i rriten gjasat për të shkuar në Evropianin e hendbollit

**PRISHTINË, 14 MARS** - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll e regjistroi një fitore të madhe në kuadër të kualifikimeve për “Euro 2026”. “Dardanët” e mposhtën Ukrainën me rezultat të ngushtë, 31:30, në një ndeshje mjaft dramatike deri në sekondat e fundit, e cila u zhvillua në Pallatin e

Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë para një numri të konsiderueshëm të shikuesve. Golat e Egzon Gjukës dhe Valon Dedajt ia siguruan ekipit kombëtar fitoren në xhiron e tretë të Grupit 6. Kosova ishte dominuese në pjesën e parë, të cilën e mbylli me katër gola epërsi, 16:12. Në pjesën

e dytë u ngushtua rezultati, por në fund verdheklaltrit u treguan më të vëmendshëm duke iu rritur shpresat për kualifikim në Evropian, që do të ishte një e arritur historike. Kosova do të luajë prapë të dielën me Ukrainën në Lituani. Dy kombëtalet e para të grupit kualifikohen në Kampionat Evropian, por

edhe katër ekipet kombëtare më të mira të vendit të tretë prej tetë grupeve sa janë gjithsej. Kështu, Kosova do ta kërkojë kualifikimin përmes vendit të tretë, ndërsa “Euro 2026” do të

mbahet nga 14 janari deri më 1 shkurt në tri shtete: Danimarkë, Suedi dhe Norvegji.



## Shqipëria paraqet fanellat e reja

Tiranë, 14 mars - Federata e Futbollit Shqiptar dhe kompania “Macron” kanë paraqitur fanellat e reja që “Shqiponjat” do të veshin në ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Botëror FIFA 2026. Lojtarët e drejtuar nga Silvino do t'i veshin fanellat e reja që në ndeshjen e parë të fazës së kualifikimeve që do të zhvillohet më 21 mars kundër Anglisë. Fanellat e reja (fanella e parë e kuqe, fanella e dytë e bardhë dhe fanella e tretë e zezë) përbëhen nga një grafikë e veçantë e stampuar, e cila, duke nisur nga simboli i shqiponjës dykrenore, përfshin një seri të pasur referencash të elementëve natyrorë dhe kulturorë karakteristikë të Shqipërisë. “Brenda dizajnit të shqiponjës, e cila është e pranishme në mëngë, në pjesën e përparme dhe të pasme të fanellës, janë përfshirë shumë simbole, secili me një kuptim specifik: Shqiponja jonë dykrenore, e ndërtuar nga detaje që pasqyrojnë bukurinë, natyrën dhe shpirtin e pasur shqiptar, mban në krahët e saj malin, lumin, diellin dhe detin, simbole të fuqisë dhe bukurisë së jetës sonë”, thuhet në njoftimin e FShF-së. Kjo shqiponjë mban lart guximin historik të Skënderbeut, duke na kujtuar traditat tona më të thella,



me kundërshtarin në mes, përballë syve të shqiponjës. Një shqiponjë që simbolizon zemrën, bashkimin, krenarinë, pak dinakëri dhe një pasion të thellë për lojtarët tanë, heronjtë modernë që vijnë nga katër anët e botës për të përfaqësuar me krenari Shqipërinë në çdo sfidë në fushë. Një skuadër e bashkuar fort, një shpirt i mbushur plot, një komb që mbetet gjithmonë krenar. Fanella e parë për ndeshjet në shtëpi është në ngjyrën tradicionale të kuqe (ngjyrën e flamurit shqiptar) me shiritin kuq e zi në pjesën e qafës dhe skajet e mëngëve. Grafika

karakteristike është e stampuar në pjesën e përparme dhe të pasme, duke formuar një shqiponjë të plotë, e përbërë nga elementë si Skënderbeu, mali, deti, anija, yjet, dhelpra etj., elementë të historisë dhe folklorit shqiptar ndër shekuj. Në gjoks, të dyja të printuara në silikon, janë të pranishme në të djathtë Macron Hero dhe në të majtë logoja e FShF-së. Në pjesën e pasme të qafës, brenda, është personalizuar me një etiketë me ngjyrë të kuqe dhe detajet në ngjyrën e grafikës së pranishme në fanellë, mbi të cilën është logoja e FShF-së.

## Lakersat pësojnë humbjen e tretë radhazi, ngjitet Golden State, fitojnë Chicago e Orlando

**MILWAUKEE, 14 MARS** - Humbja e tretë radhazi për lakersat, që u mund me rezultat 126-106 nga Milwaukee, në një ndeshje të komanduar nga vendasit. Luka Donçiqi realizoi 45 pikë për kalifornianët, por i vetëm nuk mundi të bëjë asgjë (mungoi LeBron). Për Bucksin katër lojtarë realizuan mbi 20 pikë. Ngjit shkallët në renditje skuadra e Golden States, që falë një loje të mirë kolektive (tetë lojtarë realizuan mbi 10 pikë) mundi me rezultat 130-104 Sacramenton. Fitoi edhe Orlando, që mundi me rezultat 113-93 New Orleansin, ndeshje



ku u dallua Paolo Banchero me 34 pikë e 11 rebounde. Buzëqesh skuadra e Chicagos, që mundi me rezultat 115-110 Brooklynin, një përballje e hapur deri në fund. Coby White

me 31 pikë bëri diferencën në fushë për Bulls. Fitore në sekondat e fundit për Washingtonin, që mundi me rezultat 129-125 Detroitin, ku vendimtar ishin 51 pikët e lojtarëve të stolit.

| REZULTATET                |         |
|---------------------------|---------|
| Detroit - Washington      | 125-129 |
| Milwaukee - Lakers        | 126-106 |
| Chicago - Brooklyn        | 116-110 |
| New Orleans - Orlando     | 93-113  |
| Golden State - Sacramento | 130-104 |

### SHKURT

#### Josa emërohet trajner i Suharekës

Trajneri nga Shqipëria, Mirel Josa, është emëruar trajner i skuadrës së Suharekës. Trajneri i njohur është ndarë një ditë më parë me skuadrën e Vëllaznimit, por punën do ta vazhdojë sërisht në Kosovë. Klubi i Suharekës ka ambicie të kthehet mes atyre që pretendojnë për një vend në Evropë dhe për trofe në të ardhmen. “FC Suhareka ka arritur marrëveshje me trajnerin e njohur Mirel Josa, i cili nga sot merr drejtimin e skuadrës. Me një përvojë të madhe në futbollin shqiptar, Josa pritet të sjellë stabilitet dhe sukses tek ekipi ynë”, thuhet në njoftimin e klubit të Suharekës.

#### Shqipëria merr medaljet e para të arta në Lojërat Olimpike Speciale Dimërore

Në debutimin e saj në këtë kompeticion prestigjioz, Skuadra Olimpike Speciale e Shqipërisë ka shkëlqyer me paraqitjen e sportistëve me aftësi të veçanta, duke siguruar dy medalje ari. Elizon Kacanja në Ski Alpine dhe Stela Salla në Cross Country Skiing u stolisën me të arta, teksa një medalje Argjendi e fitoi edhe Elizon Kacanja në Giant Slalom dhe dy medalje bronzi u morën nga Joanis Myrtollaris në Ski Alpine dhe Joel Gërmenji në Snowshoeing (50m). Ministria e Arsimit dhe Sportit e Shqipërisë, Ogerta Manastirliu, tha se “kjo është një arritje e jashtëzakonshme e sportistëve tanë specialë”. “Urime kampionë!”, shkroi Manastirliu.

#### Messi rikthehet me gol, Inter Miami kualifikohet në çerekfinale

Inter Miami është kualifikuar në çerekfinale të Concacaf Champions Cup. Megjithatë, ky ndoshta nuk ishte lajmi kryesor në këtë ndeshje, pasi që Leo Messi u rikthye, teksa u inkuadrua në lojë në minutën e 53-të. E në minutat shtesë argjentinasi arriti të shënojë gol për 0-2 në ndeshjen ndaj Cavalierit.

#### Hummels: U kërkoj falje tifozëve dhe bashkëlojtarëve

Mbrojtësi i Romës, Mats Hummels, ka kërkuar falje për një gabim që çoi në një karton të kuq të hershëm në humbjen 3-1 të Romës kundër Athletic Club. Mbrojtësi gjerman mori një karton të kuq pas vetëm 11 minutash në “Estadio San Mames”. “Më vjen keq, Roma. Dua t’u kërkoj falje tifozëve tanë dhe bashkëlojtarëve të mi”, ka shkruar Hummels në “Instagram”. “I zhgënjeva të gjithë sot me një gabim që ishte thjesht prej një budallai dhe i tmerrshëm. Këto lojëra dikur ishin lojërat që skuadra ime mund të mbështetej tek unë. Tani unë jam i shqetësuar dhe i kushtoj të gjithë klubit ëndrrën për ta fituar Ligën e Evropës. Nuk di çfarë të them tjetër. Jam po aq i zhgënjyer si të gjithë ju”, ka shkruar Hummelsi. Mbrojtësi 36-vjeçar ka bërë 17 paraqitje me Romën këtë sezon, duke shënuar një gol.

## Schlotterbeck shihet si zëvendësues për Van Dijkin në Liverpool

Zëvendësuesi i mbrojtësit, Virgil van Dijk, te skuadra e Liverpoolit mund të vijë nga Bundesliga. Javët e fundit Liverpooli ka bërë lëvizje për


të gjetur një zëvendësues të denjë për holandezin, të cilit i skadon kontrata me “The Reds” më 30 qershor. Siç raportohet nga “Sport

Bild”, Nico Schlotterbeck, qendërmbrojtësi i Borussia Dortmundit, është zgjedhja numër një nga drejtuesit e Liverpoolit.

Gjithsesi, për skuadrën angleze nuk do të jetë e lehtë ta marrë 25-vjeçarin. Çmimi minimal i kërkuar nga Borussia Dortmundi për

lojtarin është 50 milionë euro, duke pasur parasysh se gjermani aktualisht ka një kontratë që skadon në verën e vitit 2027.





KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh.A. konkretisht Nenin 11 dhe 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, në Vendimin e datës 14/03/2025 me numër të protokollit 02/01/223 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, shpallë këtë:

## KONKURS PUBLIK

### Për plotësimin e vendit të punës

|                                   |                                                         |
|-----------------------------------|---------------------------------------------------------|
| Titulli i vendit të Punës:        | Udhëheqësi i Njesisë për komunikim Publik dhe Marketing |
| Nr. i kërkuar:                    | Një (1) pozitë, në KRM “Pastrimi” SH.A                  |
| Numri i Referencës:               | KJ/KE-07/2025                                           |
| Koeficienti/Paga mujore:          | Niveli VII                                              |
| Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: | Me kohë të pa caktuar                                   |
| Periudha Provuese:                | 3 muaj                                                  |

### 1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- 1.1 Ndërmarrja e veprimeve për prezantimin e politikave të kompanisë, nëpërmjet komunikimit në kohën e duhur, në mënyrë që publiku të informohet për politikat e kompanisë;
- 1.2 Ofron përkrahje profesionale për kompaninë në fushën e komunikimit dhe informimit;
- 1.3 Propozon, harton dhe siguron zbatimin e planeve të komunikimit të kompanisë;
- 1.4 Organizon konferenca për media dhe përgatit njoftime për shtyp, deklarata, raporte dhe publikime tjera mediale;
- 1.5 Në bashkëpunim me zyrtarët e Teknologjisë informative mirëmban ueb faqen zyrtare të kompanisë, rrjetet sociale dhe çështjet e protokollit zyrtar;
- 1.6 Koordinon kërkesat për qasje në dokumente publike dhe përgatit raporte mbi zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike;
- 1.7 Siguron që media të jetë plotësisht e informuar për politikat dhe aktivitetet e kompanisë;
- 1.8 Shërben si ndërlidhës zyrtar me publikun dhe mediat lidhur me çështjet e komunikimit;
- 1.9 Kryen edhe punë të tjera që i kërkojnë nga Kryeshefi;
- 1.10 Për punën e tij i raporton Kryeshefit Ekzekutiv

## 2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ Arsimimi i kërkuar: Diplomë Universitare në fakultetin e Gazetarisë, Komunikimit Masiv apo të ngjashme
- ✓ Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 3 vite përvojë pune profesionale

#### 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

**5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre**

|                                                                                              |   |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|---|
| Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati                                         | ✓ |
| CV - në                                                                                      | ✓ |
| Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore                                       | ✓ |
| Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)          | ✓ |
| Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)                                 | ✓ |
| Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)                         | ✓ |
| Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës       | ✓ |
| Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale, JO më të vjetër se 3 muaj | ✓ |

#### 6. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

- \* në Zyrat e Burimeve Njerëzore në KRM “ Pastrimi” SH.A.

- \* vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: [punesimi.krmpastrimi@gmail.com](mailto:punesimi.krmpastrimi@gmail.com) dhe  
\* edhe në formë fizike në rastet e pozitive teknike.

**7. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik:**

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 15/03/2025 deri me datën 31/03/2025.

Koha e fundit e pranimiit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

### 8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim ( testi me gojë).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë;
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në gjashtëdhjetë (60) pikë;
- ✓ Intervista (testi me gojë) vlerësohet deri në tridhjetë (30) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

**9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.**

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronik dhe individualisht.

**10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:**

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë:

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit.

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Syzana Demaj shpall të pavlefshme dëftesat e sh.f. “Bajram Curri” Romaj Prizren.
- Visar Mehmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Xhavit Krasniqi Demjan Gjakove shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2. të Gjimanzit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Leard Xharavina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Benita Thaqi nga Xërxe Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Krenar Gazija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Hasan Arifi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX sh.f.m.u. “ 28 Nëntori “ Brodosan.
- Fatlind Imeraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX sh.f.m.u. “
- Dëshmoret e Hasit” Kabash i Hasit.
- Esmir Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat Q.K “11 Marsi” Prizren.
- Vahid Cocaj shpall te pavlefshme dëftesat sh.f.m.u. “ Zenun Cocaj “ Gjonaj.
- Dashurije Osmankaj shpall te pavlefshme dëftesat sh.f.m.u. “ Pjeter Budi “ Lubizhd e Hasit.
- Lirije Pajaziti shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve të Kosovës me nr. KO-8808-05-21. Motër e Anestezionit.
- Lirije Pajaziti shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve të Kosovës, drejtimi Bachelor i Shkencave në Infermieri Teknik i Anestezionit, me nr. KO-42777\A-06-20-17.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





## PRISHTINË



Duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me operatorin “Sharr Cem” Sh.p.k. Hani Elezit, ndryshim në impiant, për veprimtarinë: shfrytëzimi i lëndëve djegëse alternative (LDA) nga mbetjet jo të rrezikshme sipas katalogut shtetëror të mbeturinave 191210 “RDF” dhe gomat e përdorura të copëtuara sipas katalogut shtetëror të mbeturinave të pa rrezikshme 160103 në fabrikën e çimentos, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 11.04.2025, në ora: 11:30, në hapësirat e LAB (Laboratori për Aktivitete të Biznesit), Rr. Adem Jashari, Nr.218, 71510, Hani i Elezit, do të organizohet debat publik nga operatori “Sharr Cem” Sh.p.k. Hani Elezit, ndryshim në impiant, për veprimtarinë: shfrytëzimi i lëndëve djegëse alternative (LDA) nga mbetjet jo të rrezikshme sipas katalogut shtetëror të mbeturinave 191210 “RDF” dhe gomat e përdorura të copëtuara sipas katalogut shtetëror të mbeturinave të pa rrezikshme 160103 në fabrikën e çimentos, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “PULKO” Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810108359 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "PULKO" D.O.O. od Mitrovice, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810108359 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “PULKO” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 810108359 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly requested to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime  
drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

[www.facebook.com/gjeipuneshpeite](http://www.facebook.com/gjeipuneshpeite)

# RESTAURANT


# SWISS

# TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

📍 Mbrapa Teatr-it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi







# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

